



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d**, dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 10, paragrafi 1.1 i Ligjit nr. 04/L – 144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 20, paragrafi 11 të Rregullores QRK 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, të nenit 33.2 shkronja **a** dhe të nenit 34.1 shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01.nr. 110-391, të dt.25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 12.10.2018, miratoi këtë

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
AUTORITETIT RREGULLATIV TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE
POSTARE (ARKEP)

- I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), pa procedurë konkurrimi.
- II. Prona e e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim, ka këto karakteristika: parcela kadastrale nr. 00008-1, me sipërfaqe prej 600 m², e identifikuar në Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme, nr. P-71914032-00008-1, e dt. 20.06.2018, ZK Zllatar, pasuri shoqërore, Kuvendi komunal Prishtinë.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën II të këtij vendimi, është zbatimi i Projektit të radio-monitorimit në Republikën e Kosovës.
- IV. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij propozimi, është afatgjatë, në periudhën kohore deri në 99 vjet.
- V. Prona e paluajtshme e përshkruar në pikën II të këtij propozimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.



VI. Mënyra dhe kushtet për shfrytëzimin e pronës së paluejshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.

VII. Prona e paluejshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.

VIII. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.

IX. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është skica gjeodezike.

X. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-020/01-249488/18, më 15.10.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text 'KOMUNA E PRISHTINES' at the top, 'KUVENDI I KOMUNES' in the middle, and 'PRISHTINE' at the bottom. The signature is written in a cursive style.